

TV Debat rajonale në TV Uskana “Respektimi i të drejtave të bashkësive etnike jo shumicë në rajonin e Kërçovës”

Më 12 qershor të vitit 2008 në studion e TV Uskana në Kërçovë, prej orës 20.00 deri 21.00 u emitua TV debati “Respektimi i të drejtave të bashkësive etnike jo shumicë në rajonin e Kërçovës”

Qëllimi i debatit ishte të shqyrtohet gjendja me respektimin e të drejtave të bashkësive etnike joshumicë në komunat e Kërçovës, Drugovës dhe Vraneshticës dhe njëkohësisht të informohen qytetarët për institucionet dhe mekanizmat të cilët ekzistojnë për mbrojtjen e të drejtave të bashkësive etnike jo shumicë. TV debati u zhvillua në gjuhën maqedonase, kurse u emitua në dy gjuhë e titluar në gjuhën shqipe.

Në debat morë pjesë personat në vijim: Mirjana Najçevska, ekspert për të drejtat e njeriut, Daut Selimi, Zëvendës Avokati i Popullit në zyrën rajonale në Kërçovë, Nuhi Jusufi, sekretar në komunën e Kërçovës dhe Mladen Vançoski, kryetar i Komisionit për marrëdhënie mes bashkësive në Komunën e Drugovës.

Mirjana Najçevska dha një pasqyrë për rregullimin e të drejtave të bashkësive në vendin tonë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Maqedonisë dhe implementimi i institucioneve të reja për zbatimin e ligjeve. Qeveria e Republikës së Maqedonisë duhet ta ratifikon Kartën për gjuhët e pakicave të Këshillit të Evropës me qëllim që të gjitha bashkësitë etnike të jenë në pozitë të njëjtë. Nuhi Jusufi foli për rregullimin e të drejtave të bashkësive etnike në nivel lokal duke e aprovuar Ligjin e ri për vetëqeverisje lokale i cili zbatohet nga 1 korriku i vitit 2005, si edhe funksionimi i Komisionit për marrëdhënie mes bashkësive. Daut Selimi i prezantoi kompetencat dhe punën e deritanishme të Avokatit të Popullit. Mladen Vançoski theksoi se komuna e Drugovës është mes komunave të para të cilat kanë formuar Komision për marrëdhënie mes bashkësive edhe pse nuk kanë obligim ligjor për një gjë të tillë. Ai gjithashtu foli për përbërjen dhe funksionimin e Komisionit dhe trajtimin e bashkësive etnike që nuk janë shumicë pa marrë parasysh përqindjen e përfaqësimit të tyre në komunë.

Në kuadër të debatit u prezantuan qëndrimet e organizatave joqeveritare për respektimin e të drejtave të bashkësive etnike. Aksent i veçantë u vu në përfaqësimin joadekuat të romëve, turqve dhe shqiptarëve në institucione dhe kuadri joadekuat arsimor për mësimin në gjuhën turke në dy shkolla elementare në Kërçovë dhe Drugovë.

Gjatë TV debatit u emitua edhe një anketë e bërë me qytetarët. Qytetarët e anketuar si probleme i theksuan moszbatimin i dygjuhësisë, shtypi dygjuhësor në administratën e komunës së Vraneshticës dhe përfaqësimi i bashkësive etnike në institucionet në rajon. Gjithashtu, një numër i madh i qytetarëve nuk janë të njoftuar sa duhet me konceptin e të drejtave të bashkësive etnike, si edhe me ekzistimin e institucioneve që i mbrojnë këto të drejta.

Debatin e moderoi gazetari Lulzim Aliu.